

VENDIM
Nr. 279, datë 12.5.2021

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË OBJEKTIT SOCIAL-KULTUROR, PALLATI I KULTURËS, BASHKIA SHIJAK, DHE KAKTIMIN E BASHKISË SHIJAK SI NJËSI ZBATUESE
(ndryshuar me vendimin nr. 321, datë 18.5.2022; nr. 779, datë 12.12.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 192 687 839 (njëqind e nëntëdhjetë e dy milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e tridhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objektit social-kulturor, Pallati i Kulturës, Bashkia Shijak.

2. Bashkisë Shijak, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, i transferohet fondi në masën 38 120 227 (tridhjetë e tetë milionë e njëqind e njëzet mijë e dyqind e njëzet e shtatë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të objektit social-kulturor, Pallati i Kulturës, Bashkia Shijak, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

2/1. Bashkisë Shijak, në buxhetin e miratuar për vitin 2022, i transferohet fondi në masën 2 086 701 (dy milionë e tetëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e një) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objektit social-kulturor, Pallati i Kulturës, Bashkia Shijak, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

2/2. Bashkisë Shijak, në buxhetin e miratuar për vitin 2022, nga fondet e rindërtimit, miratuar për vitin 2022, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar në masën 1 536 000 (një milion e pesëqind e tridhjetë e gjashtë mijë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit dhe ndërtimit të infrastrukturës publike, Pallati i Kulturës, Bashkia Shijak.

3. Kaktimin e Bashkisë Shijak si njësi zbatuese për rindërtimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e objektit social-kulturor, Pallati i Kulturës, Bashkia Shijak.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe